



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO POLJE
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË KOSOVË

Datë:01.06.2026

Bazuar në Ligjin nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, neni 5 pika b), në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, Ligjin nr. 08 L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, neni 8,9,32, Udhëzimin Administrativ (MASHTI) 03-2022 për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë, Drejtoria Komunale për Arsim shpallë:

KONKURS

(Për regjistrimin e fëmijëve në Institucionin Parashkollor për vitin shkollor 2026-2027)

Institucioni Parashkollor	Grupmosha	Numri i klasëve	Numri i fëmijëve që pranohen për klasë	Gjithsej
IP "Gëzimi Ynë" 2	0-3 vjeç	2	14	28
IP "Gëzimi Ynë" 2	3-6 vjeç	3	22	66
				94

Procedurat për regjistrimin e fëmijëve në institucionin parashkollor për fëmijët nga 9 muaj deri në 6 vjeç :

1. Dokumentet e nevojshme për aplikim

- 1.1. Formulari për aplikim që duhet të përmbajë;
- 1.2. Emri i fëmijës/emri dhe mbiemri i prindit, kujdestarit ligjor;
- 1.3. Ekstrakti i lindjes;
- 1.4. Faturë të shërbimeve komunale, jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- 1.5. Data e dorëzimit të kërkesës;
- 1.6. Nënshkrimi i prindit/kujdestarit ligjor;
- 1.7. Dëshmia nga mjeku për gjendjen e përgjithshme shëndetësore të fëmijës;
- 1.8. Dëshmia për vaksinimin e fëmijës (fletorja e shëndetit të fëmijës);

2. Aplikimi duhet të përmbajë të dhëna për prindërit/kujdestarin ligjor:

- 2.1. Vërtetim për marrëdhënien e punës (nëse punon), kualifikimi dhe nr. i telefonit, email adresa;
- 2.2. Numri i anëtarëve të familjes së ngushtë;
- 2.3. Pasqyra e trustit për 6 mujorin e fundit;
- 2.4. Numri i fëmijëve tjerë të vendosur në Institucionet parashkollore përkatëse.
- 2.5. Dokumente të tjera origjinale ose të noterizuara për të dëshmuar kategorinë përkatëse që lirohen nga pagesa sipas tarifave të komunës (fëmijët e familjeve me asistencë sociale, grupet e marginalizuara që janë në asistencë sociale, fëmijët e strehuar në strehimoret e dhunës në

familje për aq kohë sa të njëjtit qëndrojnë atje, maksimumi 6 muaj, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, fëmijët e prindit vetmbajtës, fëmijët që jetojnë me njërin nga prindërit, fëmijët e veteranëve të luftës).

3. Kriteret e nevojshme për regjistrim të fëmijëve në institucionin parashkollor

- 3.1. Vetëm fëmijët e prindërve që janë banorë të Komunës së Fushë Kosovës mund të regjistrohen në Institucionin Parashkollor “Gëzimi Ynë” 2 në Fushë Kosovë.
- 3.2. Prioritet për pranim kanë fëmijët, prindërit e të cilëve janë në marrëdhënie pune dhe e dëshmojnë atë me dokumentacion të vlefshëm dhe fëmijët e stafit edukativ që janë me gjdhënie, por jo në grupin që ajo punon në institucion. Përparësi pranimi kanë edhe fëmijët e dytë apo të tretë, nëse Institucionet Parashkollorë, ka vende të lira.
- 3.3. Përfshirja në Institucionin Parashkollor “Gëzimi Ynë” është me pagesë, dhe pagesa mujore për participim nga prindërit bëhet sipas tarifës së vendosur nga Komuna e Fushë Kosovës.
- 4.4. Fëmijët që vijnë nga grupet e rrezikuara lirohen nga pagesa (fëmijët e familjeve me asistencë sociale, grupet e marginalizuara që janë në asistencë sociale, fëmijët e strehuar në strehimoret e dhunës në familje për aq kohë sa të njëjtit qëndrojnë atje, maksimumi 6 muaj, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët e braktisur dhe pa përkujdesje prindërore, fëmijët e prindit vetmbajtës, fëmijët që jetojnë me njërin nga prindërit, fëmijët e veteranëve të luftës) Për të gjitha rastet e liruar nga pagesa, prindërit/kujdestarët ligjor, duhet të dëshmojnë me dokument zyrtar (nga institucioni përkatës).
- 5.5. Fëmijët mund të aplikojnë në më shumë se 1 institucion parashkollor, por përparësi pranimi kanë në institucionin më të afërt sipas zonimit të jetesës.

4. Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë pune , nga data 01.06.2026 deri më 19.06.2026.

Aplikimi dhe dorëzimi i dokumenteve bëhet në objektin e Institucionit Parashkollor “Gëzimi Ynë” 2 në rrugën “Nënë Tereza” çdo ditë pune prej orës **09:00** deri në orën **13:00**. Pranimi i fëmijëve në Institucionin Parashkollor publik “Gëzimi Ynë” 2 bëhet në bazë të plotësimit të kriterëve të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ (MASHTI) **03-2022** për përfshirjen e fëmijëve në institucione parashkollore në Kosovë, ndërsa rezultatet shpallen më 22.06.2026.

Vërejtje: Dokumentacioni i pakompletuar dhe jashtë afatit zyrtar nuk do të merret në shqyrtim!

Drejtori i Drejtorisë për Arsim

Adriatik Zeqiri

